



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.2373/24 Datë: 20.11.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr.13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Manualin e Standardeve për Vlerësimin e Programeve të Doktoratës të përditësuar në vitin 2020, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 130 të mbajtur më datë 01.11.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Rikreditohet programi e studimit të Universitetit të Prishtinës, për periudhën **pesë (5) vjeçare**, (1 tetor 2024 - 30 shtator 2029):
 - Shëndeti Publik PhD 180 ECTS (R) *me kuotën maksimumi 4 studentë për vit akademik.*
- II. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Universiteti i Prishtinës që të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti i Prishtinës të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshim të bartësve aprovet me vendim nga KShC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti i Prishtinës brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programit të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Shëndeti Publik PhD 180 ECTS (R)	Merita Berisha Lul Raka Sefedin Muçaj Naser Ramadani Naim Jerliu

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit AKA ka organizuar vizitat në Universitetin e Prishtinës me ekspertë të jashtëm ndërkombëtarë të akreditimit.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Standardeve për Vlerësimin e Programeve të Doktoratës ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. **Për programin e studimit; Shëndeti Publik PhD 180 ECTS**, vizita me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: *Milan Pol, Joke Denekens dhe Matej Drobnic*, është organizuar më 09.09.2024 ku gjatë vlerësimit ky program është vlerësuar se i përmbushë plotësisht të gjitha fushat e standardeve të përcaktuara me Manualin e Standardeve për Vlerësimin e Programeve të Doktoratës.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 130-të, të mbajtur më datë 01.11.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit të Prishtinës dhe duke u bazuar në vlerësimet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe në rekomandimin përfundimtar të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur me sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

